



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL. Anr.151/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Afijete Sada Gllogjani dhe Ymer Hoxha anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Rahovec, për shkak të përdorimit të të miturve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa ZL.Anr.151/2017 e datës 09.10.2017, e parashtruar nga BIRN me seli në Prishtinë, me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes.

A r s y e t i m

Organizata BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP, me datën 09.10.2017, me të cilën pretendon se me datën 08.10.2017 rreth orës 15:00 dhe 19:00 në dy postime kandidati për kryetar të Komunës së Rahovecit, Ibrahim Kryeziu nga radhët e subjektit politik LDK në faqen e tij publike në Facebook vrehen dy postime të tij i cili ka përfshirë persona të mitur në fushatë zgjedhore. Me këtë rast sipas pretendimit në ankesë thekson se subjekti politik LDK ka bërë shkelje të dispozitës së Nenit 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr.13/2013.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 10.10.2017, subjekti politik LDK, thekson se ankesën e BIRN dhe IKS të bërë ndaj subjektit të tyre e konsideron si të pabazuar sepse sipas fotove të bashkangjitura në ankesë nuk ka ndonjë shkelje nga ana e Kandidatit për Kryetar të Komunës së Rahovecit Ibrahim Kryeziu mund të vërehet se gjatë manifestimit të LDK-së shihen disa fëmijë në thonjëza sepse nuk mund të identifikohet saktë moshën e tyre dhe se ata kanë qenë në katin e dytë e jo në hapësirat ku është duke u zhvilluar tubimi. Ndërsa lidhur me fotografën e dytë subjekti politik LDK në përgjigjen e tyre thekson se kandidati në fjalë shihet në një lokal duke luajtur biliardo ndërsa një fëmijë qëndron aty pranë në lokal që është i hapur për të gjithë i cili ka qenë aty kur ka hy kandidati për të biseduar me pronarin. Në

vazhdim të përgjigjes theksohet se kandidati në fjalë nuk ka asnjë ndërlidhje me të cilën shihet edhe qëndrimi indiferent i kandidatit në raport me fëmiun . Pavarësisht kësaj është kërkuar nga z. Ibrahim Kryeziu që të largoj fotot nga rrjeti social facebook me qëllim që të mos keqkuptohet dhe keq interpretohet një veprim i tillë. Me propozim për panelin që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar e ka kryer shkeljen gjatë fushatës zgjedhore të Zgjedhjeve Lokale 2017. Nga prova e ofruar nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklama e shkelësit të supozuar është publikuar gjatë fushatës zgjedhore sepse data dhe ora e paraqitur në fotografi, në shiritin e statusit të pajisjes (fusha e notifikimeve) nuk e dëshmon faktin se e njëjta është publikuar gjatë fushatës zgjedhore me 08.10.2017 siç pretendon parashtruesi i ankesës, ngase nga fotografia që është paraqitur reklama nuk ekziston data dhe ora e reklamimit-publikimit. Po ashtu në fotografit e ofruara nga parashtruesi i ankesës, në foton e parë nuk shihet asnjë element i Fushatës në postim ndërsa në foton e dytë shihet se është fushat zgjedhore ndërsa sa i përket pretendimeve që janë përfshirë persona të mitur në fushatë nuk mund të identifikohen se a janë të mitur.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 dhe 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

ZL.Anr.151/2017 më datën 12.10.2017.



**Kryesuese e Panelit
Fejzullah Rexhepi**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.